

Бр./Nr. \_\_\_\_\_  
Скопје/Shkup, \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_

Organet dhe institucionet shtetërore të sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke filluar nga përpjekjet për të siguruar respektimin e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, integritetit profesional, transparencës dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, miratojnë politikën e mëposhtme:

## POLITIKA E INTEGRITETIT

Organet shtetërore dhe institucionet e sektorit publik, në Republikën e Maqedonisë së Veriut e pranojnë integritetin, si themel të qeverisjes së mirë dhe një përgjegjje strategjike dhe të qëndrueshme ndaj korrupsionit. Integriteti është thelbësor për prosperitetin ekonomik, social dhe shoqëror.

Integriteti nënkupton kryerjen e punës në mënyrë të ligjshme, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente, me të cilën personat zyrtarë ruajnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e institucionit në të cilin ata janë përgjegjës, d.m.th. ata janë të punësuar, eliminojnë rreziqet dhe heqin dyshimet në mundësinë e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit, dhe kështu sigurojnë besimin e qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike, dhe në punën e institucioneve publike.

Forcimi dhe ngritja e integritetit, është një mision dhe përgjegjësi e përbashkët e të gjitha institucioneve në sistem, dhe në të gjitha nivelet e pushtetit.

Duke pranuar politikën e integritetit, Autoriteti i Auditimit për Auditimin e Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit (IPA) angazhohet për (1) krijimin e një sistemi të integritetit në institucione, (2) zbatimin dhe mbështetjen e sistemit të integritetit, dhe (3) ndjekjen dhe raportimin e zbatimit të sistemit të integritetit.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, i njofton ato me politikën e tij të integritetit dhe pjesëtarët e sektorit privat, shoqërisë civile dhe qytetarët duke u kërkuar atyre si partnerë në proces, të respektojnë vlerat dhe standardet e përcaktuara në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe institucionet e sektorit publik.

### 1. Krijimi i një sistemi integriteti

Sistemi i integritetit, është krijuar në mënyrë që t'u mundësojë organeve dhe institucioneve shtetërore nga sektori publik, të punojnë dhe të kryejnë kompetencat e tyre në pajtim me ligjet, dhe në pajtim me standardet më të larta etike.

Sistemi i integritetit bazohet në elementët e mëposhtëm që përfaqësojnë një lloj standardi integriteti:

- Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- Respektimi i kodit të etikës, që është i rëndësishëm për pozicionin e zyrtarit;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore bazuar në një sistem merite dhe kualifikimesh;
- Menaxhimi i qëllimshëm, racional dhe efikas i burimeve publike;
- Transparenca dhe qasja në informacionet me karakter publik;
- Denoncim i mbrojtur nga informatorët dhe
- Menaxhimi i cilësisë

**Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesit:** Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, dhe punonjësit e tij marrin përsipër t'i japin përparësi interesit publik, para atij privat në punën e tyre, dhe të inkurajojnë dhe zhvillojnë një kulturë organizative, që nuk toleron konfliktet e interesit dhe në të cilën përgjegjësia individuale dhe shembulli personal, janë baza për menaxhimin e mirë.

Për të mundësuar menaxhimin efektiv të konfliktit të interesit në Autoritetin e Auditimit të IPA-s, zbatohet procedura për identifikimin dhe deklarimin e qartë të interesave personale, përcaktohen rregulla të qarta për pritshmëritë e personave zyrtarë kur ekziston rreziku i konfliktit të interesit, sigurohet transparencë në procesin e zgjidhjes së situatave në të cilat lindin konfliktet e interesit, dhe zhvillohen mekanizma për monitorimin e zbatimit të rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit.

**Respektimi i Kodit të Etikës, që është relevant për pozicionin e personave zyrtarë:** Personat zyrtarë në Autoritetin e Auditimit për Auditimin e IPA-s, janë të detyruar të respektojnë Kodin e Etikës së institucionit në të cilin punojnë, i cili synon të promovojë profesionalizmin, mbrojtjen e interesit publik, llogaridhënien, përgjegjësinë, paanshmërinë, mos-diskriminimin dhe neutralitetin politik.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, zhvillon mekanizma, që mundësojnë ndjekjen e vazhdueshëm të respektimit të Kodit të Etikës nga personat zyrtarë. Për fushat që janë shumë të ndjeshme ndaj korrupsionit, siç janë prokurimi publik, Autoriteti i Auditimit për Auditimin IPA-s, gjithashtu miraton kode të veçanta të veprimit.

**Menaxhimi i burimeve njerëzore në bazë të meritës dhe sistemit të kualifikimit:** Integriteti promovohet si pjesë e menaxhimit të burimeve njerëzore në Autoritetin e Auditimit për IPA. Punësimi është transparent nëpërmjet shpalljes publike, me kritere të paracaktuara dhe politika të zhvilluara, që mundësojnë punësim dhe avancim në detyrë bazuar në merita dhe kualifikime dhe pamundësojnë ndikimet partiake, nepotizmin dhe kronizmin.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, ka identifikuar pozicionet e punës, që janë veçanërisht të cenueshme nga korrupsioni, dhe parashikon detyrime të veçanta në lidhje me mbrojtjen e integritetit. Papajtueshmëria, ndalimet dhe kufizimet e qenësishme në punën në sektorin publik duhet të respektohen vazhdimisht.

**Menaxhimi me qëllim të caktuar, racional dhe efikas i burimeve publike:** Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, demonstroi transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje në përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të nxitura nga qëllimi për të kënaqur interesin publik, dhe për të përmirësuar vazhdimisht shërbimet për qytetarët.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, merr përsipër që kontratat e prokurimeve publike, të partneritetit publiko-privat, dhënien me koncesion e burimeve shtetërore, dhënien me qira dhe shitjen e pronës dhe tokës shtetërore, etj; t'i lidh nëpërmjet procedurave transparente, që lejojnë trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e pjesëmarrësve të interesuar.

**Transparencë dhe qasje në informacionin publik:** Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, ofron informacion të vërtetë, të përshtatshëm, në kohë dhe të plotë për qytetarët dhe personat juridikë, duke respektuar të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, synon një nivel të lartë transparence aktive, pra publikon sa më shumë informacione në faqen e internetit, dhe demonstroi gatishmërinë e tij për t'u vendosur nën vëzhgim dhe kontroll publik.

Personat zyrtarë nuk guxojnë t'i përdorin informacionet, që i kanë në dispozicion në ushtrimin e funksioneve të tyre, autorizimeve publike dhe detyrave zyrtare, për të realizuar përfitim, ose avantazh për vete ose për dikë tjerët.

**Denoncim i mbrojtur nga informatorët:** Mundësimi i informatorëve të denoncojnë veprim të

palejueshëm ose të paligjshëm pa pasur frikë nga pasojat, është një nga shtyllat për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e suksesshëm të veprimeve të tilla që kërcënojnë funksionimin e institucionit.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, miraton procedurën e denoncimit të mbrojtur, dhe ka caktuar personin e autorizuar për marrjen e denoncimeve nga informatorët. Me procedurën e denoncimit të mbrojtur dhe personin e autorizuar për denoncime të mbrojtura, njoftohen të gjitha palët e interesuara.

**Menaxhimi i cilësisë:** Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, krijon një sistem pune nëpërmjet të cilit përmirësohen vazhdimisht punët dhe proceset, ulen rreziqet dhe kostot, përmirësohet motivimi i punonjësve, dhe ndiqen rezultatet e përgjithshme të punës.

Përmirësimi i rezultateve dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve kryhet nëpërmjet planifikimit të përgjegjshëm, menaxhimit dhe realizimit të proceseve dhe promovimit të kulturës së përsosmërisë së administratës publike, në pajtim me standardin ndërkombëtar ISO 9001, Kornizën e Përbashkët të Vlerësimit – CAF dhe standardet e tjera të cilësisë në sektorin publik.

## **2. Zbatimi dhe mbështetja e sistemit të integritetit**

Për të mundur zbatimin efektiv të sistemit të integritetit, Autoriteti i Auditimit të IPA-s, është i angazhuar për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen e të gjithë personave zyrtarë në procesin e përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga standardet e integritetit në drejtim të kryerjes së punëve në mënyrë të ligjshme, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente.

Strukturat drejtuese në Autoritetin e Auditimit për Auditimin e IPA-s, janë përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e sistemit të integritetit, si dhe për promovimin e tyre nëpërmjet sjelljes së tyre personale, dhe duke marrë masa për pranimin kolektiv të politikës së integritetit dhe respektimin e saj nga punonjësit.

Ngritja e kapaciteteve bëhet duke edukuar rregullisht punonjësit, për zbatimin e duhur të standardeve të integritetit nëpërmjet trajnimit, si dhe duke ofruar këshillim për të gjitha dilemat që mund të lindin për personat zyrtarë në punën e përditshme.

Për të siguruar zbatimin efektiv të sistemit të integritetit, Autoriteti i Auditimit për IPA, emëron një person përgjegjës për integritet.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, identifikon rreziqet e korrupsionit dhe i vlerëson dhe monitoron ato rregullisht. Për rrjedhojë, merren edhe masa për kapërcimin e rreziqeve që kërcënojnë integritetin e institucionit.

## **3. Ndjekja dhe raportimi mbi zbatimin e sistemit të integritetit**

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, ofron një sistem me dy nivele të ndjekjes së zbatimit të sistemit të integritetit, në nivel të vetë institucionit, dhe nga institucioni kompetent, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim KSHPK).

Qëllimi i ndjekjes së sistemit të integritetit në Autoritetin e Auditimit të IPA-s, është përcaktimi i efektivitetit të politikave dhe procedurave të zbatuara, që mundësojnë zbatimin e qëndrueshëm të standardeve të integritetit, si dhe matjen e rezultateve të masave të zbatuara, për uljen e rreziqeve të korrupsionit. Procesi i ndjekjes dhe raportimit, për zbatimin e sistemit të integritetit koordinohet nga personi i integritetit. Autoriteti i Auditimit të IPA-s, gjithashtu zbaton kontrole të brendshme për të verifikuar zbatimin e standardeve të integritetit, duke përfshirë auditimin e brendshëm.

Autoriteti i Auditimit për Auditimin e IPA-s, është i angazhuar për bashkëpunim me KSHPK-në, duke bërë të mundur monitorimin e zbatimit të sistemit të integritetit. Për këtë qëllim, Autoriteti

i Auditimit për Auditimin e IPA-s, angazhohet për informim të saktë, të rregullt dhe në kohë të KSHPK-së, për të gjitha aktivitetet e ndërmarra me qëllim zbatimin e sistemit të integritetit, si dhe për zbatimin e udhëzimeve, rekomandimeve dhe indikacioneve të marra nga KSHPK-ja, në lidhje me forcimin e integritetit në institucione.

**Auditori i Përgjithshëm për IPA,**

**Adem Curi, ОДР, СИИ, ОС**